

Promovimi i sipërmarrjeve, Ekonomi viziton Kantinën Kokomani



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, zhvilloi një vizitë në Kantinën Kokomani, në bashkinë e Shijakut, një biznes familjar i suksesshëm që ka arritur të tërheqë turistë të shumtë, për shkak të verës shumë të mirë që ata prodhojnë dhe që është nderuar për disa vite rresht me

çmime të para kombëtare, por dhe për shkak të mjedisit çlodhës, panoramës së bukur dhe ushqimit tepër të shijshëm dhe të servitur bukur në pllajën e kodrës ku kjo kantinë ndodhet. Kokomani prodhon rreth 70 mijë shishe në vit, dhe përveç se furnizon një pjesë të mirë të bizneseve dhe restoranteve të mira në Tiranë, gjithashtu dhe eksporton në disa vende. Ministria Ekonomi shprehu vlerësimin e saj për këtë sipërmarrje të suksesshme, duke dëgjuar nga sipërmarrësit dhe problematikat përkatësi. Sipërmarrësi Kokomani kërkoi që qeveria të bëjë përpjekje të nxisë prodhimin në vend të lëndëve të para për ambalazhimin e verës, si shishet e qelqit, apo fuçitë e drurit, pasi blerja e tyre nga jashtë e rrit koston e produktit shqiptar dhe e bën të pamundur konkurrencën në eksport.

Mbështetje e mëtejshme për rritjen ekonomike dhe nxitjen e punësimit



Rritet mbështetja e Gjermanisë ndaj qeverisë shqiptare për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rajonal dhe punësimit, si dhe për të sjellë më shumë shqiptarë pranë punës. Krahas projekteve ekzistuese Qeveria Federale ka vënë në dispozicion edhe një fond tjetër prej gjashtë milionë eurosh. Ambasadorja gjermane

Susanne Schütz e njoftoi këtë mbështetje shtesë në një aktivitet së bashku me Zv.Kryeministrin shqiptar z. Niko Peleshi. "Për Qeverinë Federale është e rëndësishme të krijohen perspektiva të zhvillimit profesional, veçanërisht për të rinjtë", u shpreh Ambasadorja Schütz. Me këto fonde shtesë do

të financohen ndër të tjera projekte trajnimi dhe kualifikimi pranë shkollës profesionale të Kamzës si dhe trajnime për aplikime të ndryshme, oferta konsulence profesionale dhe praktika pranë sipërmarrjeve private. Veç kësaj synohet të mbështeten sipërmarrës të rinj, të cilët zhvillojnë ide inovative biznesi. “Tashmë, janë miratuar nga Qeveria dhe ratifikuar në Parlament edhe 13 marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me Gjermaninë duke aktivizuar 31 Milionë Euro Grant dhe 37 Milionë Euro Kredi” – u shpreh Zëvendëskryeministri, Z. Niko Peleshi. Gjermania angazhohet në mënyra të shumta për të krijuar bashkërisht me qeverinë shqiptare perspektiva për të ardhmen në vend. Që prej një gjysmë viti ekziston zyra gjermane e informimit rreth çështjeve të migrimit, formimit profesional dhe karrierës (DIMAK), e cila mbështet personat në kërkim të një vendi pune për të patur akses në tregun shqiptar të punës, sikurse edhe informon rreth mundësive të ligjshme të emigrimit drejt Gjermanisë. DIMAK do të marrë edhe 600.000 euro për të zgjeruar veprimtarinë e vet dhe për ta ofruar atë edhe jashtë Tiranës. Gjermania është donatori më i madh bilateral për Shqipërinë për sa i përket bashkëpunimit ekonomik dhe në vitet 2017 e 2018 do ta mbështesë atë me gjithsej 100 milionë euro.

Ministrja Ekonomi, në çeljen e sezonit turistik veror në Gjirin e Lalzit

Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, ka marrë pjesë



në çeljen e sezonit turistik në Gjirin e Lalzit. Ky event, i organizuar nga Shoqata e Restoranteve Turistikë Shqiptarë, përkoi dhe me hapjen e restaurantit më të ri në këtë zonë, “Panorama al Mare”. Në fjalën e mbajtur gjatë ceremonisë, Ministrja Ekonomi përgëzoi këtë iniciativë të Shoqatës së Restoranteve Turistikë, ndërsa vuri në dukje faktin se kjo zonë është një nga më të bukurat e

Qarkut Durrës dhe që pritet të zhvillohet akoma më shumë falë edhe investimeve dhe ndërtimeve të resorteve të reja. Gjithashtu, Ministrja Ekonomi theksoi edhe impaktin shumë pozitiv që do të ketë ulja e TVSH-së për turizmin nga 20 për qind në 6 për qind, impakt që do të ndikojë në hapjen e strukturave të reja dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit për këtë sektor. Ulja e TVSH-së për turizmin mori edhe miratimin e Kuvendit të Shqipërisë, në seancën plenare të javës së shkuar.

Ekonomi viziton panairin Vas Travel Fair 2017



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, zhvilloi një vizitë në Vas Travel Fair 2017, i cili këtë vit shënoi edicionin e tij të tretë dhe u zhvillua në datat 2-3 maj, në ambientet e Hotel Piazza. Ky event, me fokus turizmin, mbledhi në Tiranë ekspertët e turizmit nga vendet e Ballkanit dhe ato të Mesdheut, për të shkëmbyer ide mbi paketat rajonale turistike. Organizimi i këtij panairi është një mundësi e mirë për takime

mes bizneseve (B2B) mes tur operatorëve nga Turqia, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Qipro, takime nga ku krijohen mundësi që bizneset që lidhin kontratat mes tyre. Në fjalën e saj të rastit, Ministrja Ekonomi vlerësoi organizimin dhe theksoi se, evente të tilla janë një mundësi e mirë, pasi shërbejnë për hapjen e turizmit dhe gjenerimin e më shumë të ardhurave prej këtij sektori. Në Vas Travel Fair bashkëpunuan 28 partnerë, kryesisht në sektorin e hotelerisë për të prezantuar para qytetarëve oferta dhe denstacionet turistike. Tiranë ekspertët e turizmit nga vendet e Ballkanit dhe ato të Mesdheut, për të shkëmbyer ide mbi paketat rajonale turistike. Organizimi i këtij panairi është një mundësi e mirë për takime mes bizneseve (B2B) mes tur operatorëve nga Turqia, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Qipro, takime nga ku krijohen mundësi që bizneset që lidhin kontratat mes tyre. Në fjalën e saj të rastit, Ministrja Ekonomi vlerësoi organizimin dhe theksoi se, evente të tilla janë një mundësi e mirë, pasi shërbejnë për hapjen e turizmit dhe gjenerimin e më shumë të ardhurave prej këtij sektori. Në Vas Travel Fair bashkëpunuan 28 partnerë, kryesisht në sektorin e hotelerisë për të prezantuar para qytetarëve oferta dhe denstacionet turistike.

Shqipëria pret kampionatin e 9-të botëror të Fluturimeve të Lira



Në Shqipëri po zhvillohet kampionati i 9-të botëror i Fluturimeve të Lira, 9th FIA World Paragliding Accuracy Championship, nga data 5 deri në datën 14 Maj 2017, në Vlorë. Ky kampionat, me organizator kryesor Federatën Shqiptare të Aeronautikës, mbështetet edhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Mbi 28 shtete

përfaqësohen dhe rreth 150 pilotë janë bërë pjesë e kësaj gare. Ky kampionat përkon dhe me nisjen e sezonit turistik veror në qytetin e Vlorës, duke u kthyer kështu në një aktivitet të rëndësishëm që sjell më shumë turistë dhe më shumë të ardhura për ekonominë lokale. Pjesë e këtij aktiviteti është bërë edhe aktorja shqiptare me famë ndërkombëtare, Eliza Dushku, si imazhi kryesor i kampionatit të 9-të Botëror të Fluturimeve të Lira. Shqipëria fitoi të drejtën për të zhvilluar kampionatin e 9-të Botëror të Fluturimeve të Lira, duke triumfuar ndaj Kinës dhe Gjermanisë, dy vendeve të tjera që morën pjesë në konkurrim, në mbledhjen e Federatës ndërkombëtare të Aeronautikës, të mbajtur në Beograd, në vitin 2014.

Ekonomi në Mbrëmjen Gala të Albanian ICT Awards



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, ishte pjesë e Mbrëmjes Gala të edicionit të pestë jubilar të Albanian ICT Awards, së bashku me zv.kryeministrin Niko Peleshi, ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, z. Eduard Shalsi, përfaqësues nga bota e ICT-së, biznesit, akademisë, administratës publike, shoqërisë civile dhe medias. Duke përshëndetur këtë event, Ministria theksoi se në Shqipëri ka

shumë nevojë për të ndihmuar ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe fusha e ICT mund të ndihmojë mjaft mirë këto ndërmarrje që ato të tregtojnë më lehtë dhe të rriten më shpejt. Ministria Ekonomi pati kënaqësinë të jepte dy çmime: I pari për Martin Mytaberi, për merita të dalluara dhe arritjet në fushën e "Produkteve Tech Eco-Friendly", për realizimin e Koshit Vete-riciklues me sistem për ndarjen dhe seleksionimin e mbeturinave në mënyrë automatike dhe I dyti për Open Data Kosovo, për merita të dalluara dhe kontribut të jashtëzakonshëm të përmasave ndërkombëtare me aplikacionin Decode Darfur, platformë crowdsourcing në mbështetje të të drejtave të njeriut, e cila ka hulumtuar dhe gjeo-lokalizuar shkatërrimin sistematik të fshatrave të largëta të Darfurit nga Qeveria Afrikane.

AIDA, asistencë për bizneset e Bashkisë Shkodër



Stafi i përkujdesjes ndaj investitorit në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, AIDA, shoqëruar nga përfaqësues të qeverisjes lokale, kanë zhvilluar vizita në kompani të ndryshme që ushtrojnë biznesin e tyre prej vitesh në qytetin e Shkodrës. Këto vizita kanë pasur si qëllim kryesor rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit me qeverisjen

lokale në funksion të ndihmës ndaj investitorëve të huaj dhe vendas, si edhe dëgjimin nga afër të problemeve që kanë biznesit për të ndërmjetësuar në adresimin e tyre. Takimet janë zhvilluar në kompanitë "Felix" dhe "Alb-Conf", të dyja me një eksperiencë të hershme dhe me numër të konsiderueshëm punonjësish, që operojnë në sektorin e manifakturës. Gjatë takimit, kompanitë vunë në dukje rritjen e numrit të klientëve dhe zgjerimin e biznesit të tyre. Gjithashtu, ato kanë raportuar për një përmirësim në marrëdhëniet me administratën tatimore dhe atë doganore. Përfaqësuesit e Bashkisë së Shkodrës ishin të pranishëm gjatë vizitave të sektorit After Care të AIDA-s për të plotësuar kërkesat dhe dëgjuar nevojat e kompanive që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e mbuluar nga kjo njësi, si edhe sfidat kryesore me të cilat përballen investitorët në vend. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve nëpërmjet përfshirjes dhe ndërtimit të një rrjeti bashkëpunues me qeverisjen lokale synon të realizojë një koordinim më të mirë me qëllimin final adresimin e shpejtë dhe efikas të sfidave me të cilat përballen investitorët vendas dhe të huaj.

Llojet e patentave për të cilat shqiptarët kanë aplikuar në 2016

Për çfarë lloje patentash kanë aplikuar shqiptarët në vitin 2016? Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale bën të ditur se, gjatë vitit 2016 në DPPM, sot DPPI, ka patur 23 aplikime për patenta mbi shpikjet dhe 4 për modele përdorimi. Të gjitha aplikimet janë depozituar nga individë, nga të cilët 4 janë studentë dhe 2 pensionistë. Aplikimet janë në fazë ekzaminimi. Pas 18 muajve ato bëhen publike në buletinin e DPPM. Nga këto 23 aplikime, vihet re se numrin më të madh e përbëjnë aplikimet për patentat në fushën elektronike/elektroteknike, ndjekur më pas nga aplikimet për patentat në fushën mekanike.

Publikohet standardi për programet kualifikuese/trajnuese të udhërrëfyesit turistik



Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ka publikuar së fundmi Standardin SSH EN 15565:2008 "Shërbimet e turizmit - Kërkesat për dispozitat e programeve kualifikuese dhe trajnuese të udhërrëfyesit turistik profesional". Ky standard përcakton kërkesat minimale për dispozitat e programeve kualifikuese dhe trajnuese të guidave turistike profesionale. DPS bën të ditur se, kërkesat për programet e trajnimit të përcaktuara në këtë standard janë

minimale; ato nuk e përjashtojnë dhënien e trajnimeve shtesë ose vlerësimin e kompetencave shtesë. Si mund ta bëni tuajin standardin!? Ky standard është adoptuar nga Komiteti Teknik Nr. 304: "Dokumentacioni dhe informacioni", përmban 20 faqe, me çmim 3094 lekë dhe mund ta blini pranë zyrave të DPS. Për më tepër informacion rreth standardeve shqiptare konsultoni Katalogun e Standardeve Shqiptare online : http://www.dps.gov.al/standard/advance_search